

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë
ADRESA	https://dosja.al/insights/kur-partit-harrojne-pse-ekzistojne-i514378
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 07:43:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a71bcd070f6a18cc6939069fd536bec8620ffbd04cbd15982d800faf781512b2
TEKSTI	057f6e7b4f2126e0a5548aab65fd93b9ba230a60bf4bb207d5a258cadd5a796f
PAMJA	dc52ae206b62f5b64fefae35abaf8192713d25b9bb97013d1df8edacc9360bac

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8b98c97267da0c31cf6156e689587b75ef52b81343518e563dff8e473a99749f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8b98c97267da0c31cf6156e689587b75ef52b81343518e563dff8e473a99749f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

51 MINUTA ME PARE

Dita e verdiktit final/ Haga vendos sot për fatin e ish-krerëve të UÇK-së, qindra qytetarë mbledhen në Prishtinë: Na i ktheni djemtë në shtëpi!

11 ORE ME PARE

SYTË NGA HAGA/ Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së, rrugët mbushen me flamuj e mbishkrime për Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin: Shpallini të pafajshëm (PAMJET)

13 ORE ME PARE

108 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Edi Rama jep dorëheqjen

16 ORE ME PARE

SHBA fokus te kartelet e drogës, zv/ndihmës Sekretari i Shtetit: Po punojmë për shkatërruar organizatat kriminale. Kosovë- Serbi të shmangin provokimet

Insights

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Sot nuk kemi më nevojë për luftë për t'u ndarë. Dy vëllezër mund të përfundojnë në dy kampe politike, të shohin njëri-tjetrin si kundërshtarë, dhe një ekran, një flamur apo një parti të bëhet llogorja e tyre.



16 Shtator 2026, 09:32
Nga Auran Janku



Foto ilustruese

Ka një sëmundje politike që nuk diagnostikohet me analiza gjaku. Quhet Sindroma e Stokholmit politik: viktima fillon të mbrojtë atë që e mban peng, sepse frika e humbjes së tij i duket më e madhe se dhimbja që i shkakton. Mjafton të kthesh kokën pas. Në kohë luftërash dhe përndjekjesh, një baba mund t'i ndante djemtë në anë të ndryshme për të shpëtuar familjen. Edhe Lufta e Dytë Botërore na la tragjedinë e familjeve të ndara mes Ballit dhe partizanëve. Jo sepse vëllai donte të vriste vëllanë, por për të shpëtuar nga humbja e sigurt.

Sot nuk kemi më nevojë për luftë për t'u ndarë. Dy vëllezër mund të përfundojnë në dy kampe politike, të shohin njëri-tjetrin si kundërshtarë, dhe një ekran, një flamur apo një parti të bëhet llogorja e tyre. Kur partitë harrojnë pse ekzistojnë, demokracia fillon të humbasë oksigjen. Partitë nuk u krijuan që shqiptarët të urrenin njëri-tjetrin. U krijuan që qytetarët të zgjedhin mes mënyrave të ndryshme për ta bërë vendin më të mirë. Njëra mund të besojë më shumë te shteti, tjetra te tregu; njëra te taksat progresive, tjetra te taksat e ulëta; njëra te centralizimi, tjetra te decentralizimi.

Këto janë dallime. Demokracia ushqehet prej tyre. Problemi fillon kur dallimi kthehet në armiqësi. Atëherë politika nuk është më garë për rrugën më të mirë, por luftë për të pushtuar vetë rrugën. Qytetari shtyhet të zgjedhë kampin përpara se të zgjedhë idenë. Dhe kur kampi bëhet më i rëndësishëm se ideja, partia nuk e kërkon më qytetarin si mendje. E kërkon si numër. Këtu qëndron problemi i vërtetë. Partia politike nuk është vetëm një organizatë që regjistrohet, mbledh fonde, zgjedh kandidatë dhe hyn në zgjedhje. Ajo është shkolla e parë e pushtetit. Aty pushteti mëson të ecë përpara se të marrë çelësat e shtetit.

Mënyra si sillet një parti brenda vetes është prova më e mirë e asaj që do të bëjë nesër me vendin. Nëse kritika quhet tradhti, nuk duhet të habitemi kur në qeveri kritika shihet si pengesë. Nëse shpërblehet bindja dhe jo aftësia, administrata rrezikon të mbushet me njerëz që dinë të thonë "po" më mirë sesa të shërbejnë. Nëse një njeri kontrollon kandidaturat, strukturat, karrierat dhe vendimarrjen, është naive të besojmë se, sapo të marrë shtetin,

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 07:35

"Ju erdhi fundi"/ Sot dita e 109-të e protestës, qytetarët të vendosur deri në largimin e qeverisë: Rama, jep dorëheqjen!

AKTUALITET 16 SHTATOR 2026, 07:22

Shtrenjtimi i tarifave "zbraz" bankat e shkollave private, ku po shkojnë nxënësit

do të zgjohet papritur demokrat. Pushteti nuk lind ditën kur partia fiton zgjedhjet. Ai stërvitet shumë më herët.

Prandaj nuk mjafton të pyesim si votohet një parti. Duhet të pyesim edhe si ndërtohet ajo përpara se të kërkojë votën. Ligji për partitë nuk duhet të jetë thjesht ligj për regjistrimin, statutet dhe financat. Duhet të jetë një nga mekanizmat që mbron demokracinë nga përqendrimi i pushtetit dhe fut në sistem shumëllojshmërinë e interesave e të vullnetit qytetar.

Partitë duhet të kenë konkurrencë reale të brendshme, kufizim të drejtuesve, transparencë të kandidaturave, të drejta të anëtarësisë dhe mekanizma kontrolli. Sepse paradoksi është i madh: kërkojmë demokraci nga organizata që shpesh vetë nuk e praktikojnë. Anëtari është i nevojshëm për numrin, mitingun, votën dhe fotografinë e turmës. Por kur vjen momenti të vendoset kush kandidon, kush drejton dhe cila është ruga politike, vendimi zhvendoset lart, në një rreth gjithnjë e më të vogël. Partia fillon të ngajë me një piramidë: demokracia në bazë, vendimarrja në majë. Dhe sa më e ngushtë bëhet maja, aq më e heshtur bëhet baza.

Pastaj vjen pushteti. Partia nuk merr vetëm zyrat. Merr buxhetin, administratën, emërimet dhe mundësinë për të ndikuar mbi institucionet. Kështu një defekt partiak shndërrohet në defekt shtetëror. Një dorë që kontrollon listën e kandidatëve nesër mund të përpiket të kontrollojë institucionin. Një drejtues që nuk duron kundërshtimin brenda partisë mund të mos durojë më vonë kontrollin e Parlamentit, medias apo drejtësisë. Prandaj duhet t'i shohim duart përpara se t'u japim timonin. Demokracia nuk matet vetëm me atë që fiton. Matet edhe me kufijtë që pranon fituesi. Politika shqiptare duhet të bëjë një dallim të thjeshtë: demokracia ka nevojë për kundërshtarë politikë, jo për armiq politikë. Njëra parti duhet të thotë: "Kjo është ruga ime." Tjetra: "Unë besoj në një rrugë tjetër." Pastaj vendos populli.

Kur logjika bëhet "jam kundër teje, prandaj çdo gjë që bën ti është e keqe", politika nuk prodhon më alternativa. Prodhon tribalizëm me kostum. Tribalizmi është demokracia pasi i është hequr arsyeja dhe i është lënë vetëm zëri. Dy turma bërtasin përballë njëra-tjetrës dhe, në mes të zhurmës, dikush mund të kalojë i qetë me thesin në shpinë. Sa më shumë qytetarët merren me njëri-tjetrin, aq më pak shohin çfarë bëhet sipër tyre. Qytetari nuk duhet të jetë ushtar i partisë. Duhet të jetë gjykatësi i saj. Populli nuk është pronë e askujt. As i majtë, as i djathtë, as i qeverisë, as i opozitës. Ai është burimi i legjitimitetit të të gjithëve. Prandaj është kontradiktë që partitë, të cilat kërkojnë votën e qytetarëve dhe mbështeten edhe nga paratë publike, të funksionojnë sikur janë prona private. Kjo nuk do të thotë se partitë duhet të bëhen të njëjta. Demokracia ka nevojë për alternativa, debate dhe përplasja idesh. Një vend nuk përparon kur të gjithë mendojnë njësoj, por as kur të gjithë urrejnë njëri-tjetrin. Përparimi lind kur idetë përplasen dhe më e mira mbetet.

Pluralizmi thotë: "Mendo ndryshe nga unë." Përçarja thotë: "Nëse mendon ndryshe nga unë, je kundër meje." E para është demokraci. E dyta është terren për abuzimin me pushtetin. Nuk duhet të biem as në naivitetin tjetër. Jo çdo politikan që kërkon pushtet e kërkon për të vjedhur. Pushteti mund të jetë mjet për të ndërtuar, por mund të bëhet edhe çelës për të grabitur. Dallimi nuk duket te flamuri, ngjyra apo slogani. Duket te kufijtë që pranon pushtetari. Prandaj reforma e partive nuk duhet të synojë krijimin me ligj të "partive të mira". Ligji nuk mund të prodhojë moral politik. Por mund të vendosë gardhe aty ku pushteti kërkon të bëhet pronë. Drejtuesit duhet të zgjidhen përmes zgjedhjeve të brendshme reale, me rregulla të barabarta, lista të verifikueshme anëtarësh dhe rezultate të publikuara. Mandatet drejtuese duhet të kufizohen. Dy mandate të plota janë një kufi i arsyeshëm.

Kufizimi i mandatit nuk është ndëshkim për suksesin. Është mbrojtje kundër kthimit të suksesit në pronësi personale. Kandidaturat duhet të jenë transparente: kriteret, afatet dhe organet vendimmarrëse të bëhen të ditura. Përzgjedhja nuk duhet të varet nga vullneti i vetëm i kryetarit. Kritika e brendshme duhet të mbrohet. Anëtari që denoncon korrupsionin, shkeljet statutores apo abuzimin me fondet nuk mund të trajtohet si armik i partisë. Financat duhet të jenë të kuptueshme dhe të verifikueshme. Donatorët, shpenzimet dhe përdorimi i fondeve publike duhet të jenë transparentë, ndërsa kontrolli dhe sanksionet duhet të vlejnë edhe për partitë e mëdha. Anëtarësia duhet të marrë pjesë në vendimarrje, jo vetëm të thirret për të duartrokur vendimet e marra më parë.

Këto rregulla nuk do t'i bëjnë partitë të përsosura. Por do ta bëjnë më të vështirë që ato të kthehen në prona personale. Demokracia e brendshme nuk është luks organizativ. Është siguri publike. Një parti që mëson të respektojë rregullat brenda vetes ka më shumë gjasa t'i respektojë ato kur merr shtetin. Ndërsa një parti që i shkel rregullat për të ruajtur drejtuesit, nesër mund t'i shkelë për të ruajtur pushtetin. Partia nuk duhet të jetë thjesht një shkallë për të hipur në shtet. Sepse nëse është ndërtuar si pronë personale, shteti rrezikon të trajtohet si prona e radhës.

Nuk kemi nevojë për liderë më të fuqishëm. Kemi nevojë për institucione që nuk varen nga fuqia e një lideri. Nuk kemi nevojë për turma më të mëdha. Kemi nevojë për qytetarë më të lirë. Dhe mbi të gjitha, nuk kemi nevojë për një politikë që e quan kundërshtarin armik. Kemi nevojë për një politikë ku kundërshtari është thjesht njeriu që mendon ndryshe. Sepse demokracia nuk është arti për të fituar gjithmonë. Është arti për të humbur pa e djegur shtëpinë. Një parti demokratike duhet të dijë të fitojë, por edhe të humbasë. Një qeveri demokratike duhet të dijë të qeverisë, por edhe të largohet. Ndoshta kjo është prova më e vështirë e demokracisë shqiptare: jo mënyra si pushteti vjen, por mënyra si pranon të ikë.

Një vend nuk duhet të ketë frikë nga alternimi i pushtetit. Duhet të ketë frikë nga pushteti që nuk di të largohet. Partitë ekzistojnë për t'i dhënë qytetarit mundësi zgjedhjeje, jo për t'i marrë atij lirinë e zgjedhjes. Populli nuk është municion elektoral. Nuk është flamur. Nuk është turmë për shesh. Është arsyeja pse partitë ekzistojnë.

ANALIZË E ARDHSHËM 2020, 17/12

Një në katër të punësuar merr pagë minimale, rritet pesha e pagave më të larta

më të klikuarat



SKANDAL/ Deputetja Zëgjine Çausi ishte në dijeni se daja i saj kishte marrë peng dhe përdhunuar të renë. Viktima: Erdhi në shtëpi, tha se do na fus në telashe

Vitin e ardhshëm zgjedhjet lokale/ Qeveria 'hap thesin' për pensionistët: Nga 1 janari do dyfishohet bonusi për të gjitha kategoritë

Trafikonin sasi të mëdha kokaine/ Goditet banda shqiptare në Belgjikë, arrestohet dhe Gert Gjenerali

Rishfaqet "diMAL", pas mishit të infektuar, drogë në kontejner

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow

Dhe kur një parti e harron këtë, duhet t'i kujtojmë një të vërtetë të thjeshtë: Kush kërkon popullin për të marrë pushtetin, por harron popullin pasi e merr atë, nuk ka kërkuar të qeverisë vendin. Ka kërkuar ta zotërojë. Por republika nuk është pronë e fituesit. Është shtëpia e përbashkët e atyre që fitojnë, e atyre që humbin dhe, mbi të gjitha, e atyre që votojnë. Prandaj duhet t'i shohim partitë jo vetëm si makina elektorale, por si provën e parë të karakterit të pushtetit.

Para se një parti të marrë shtetin në dorë, ajo na tregon se çfarë dore do të ketë. Qytetari duhet ta shohë atë dorë përpara se t'i japë timonin. Sepse demokracia nuk fillon të vdesë vetëm kur dikush merr shumë pushtet. Ajo fillon të vdesë kur qytetarët mësohen të kenë frikë ta kontrollojnë atë. Kur vëllai sheh te vëllai armikun, kur qytetari sheh te kundërshtari tradhtarin dhe kur partia bëhet më e rëndësishme se liria, llogorja nuk është më në rrugë. Është brenda nesh.

Dhe aty duhet ta fillojmë edhe çlirimin: jo duke kërkuar një lider më të mirë, por duke ndërtuar rregulla që asnjë lider të mos mund të bëhet më i madh se institucioni. Jo duke kërkuar një parti që të fitojë përgjithmonë, por një demokraci që mund t'i mbijetojë çdo fituesi. Sepse Shqipëria nuk ka nevojë për një pushtet që fiton gjithmonë. Ka nevojë për një Republikë që nuk humbet kurrë.

auron janku

Sondazh

Poll

Insights

12 Shtator 2026, 10:13

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Ola Xama Po "Cereni" qe i ke dhene token e ushtrise me 1 euro per te bere restorant cfare eksporton? Dhe kjo pa patur asgje personale me person...

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Insights

2 Shtator 2026, 10:34

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Insights

28 Gusht 2026, 21:11

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat
te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e
Ksamil nën hijen e “burrave të zinj”

Insights

19 Gusht 2026, 11:08

Kur salla kthehet në pasqyrën e liderit

Insights

13 Gusht 2026, 16:08

Insights

12 Gusht 2026, 13:19

Byrotë e Kreditit: Transparencë financiare apo një barrë e re për biznesin?

Florian Zekja/ Kryetar i Manifaktura Shqiptare TIRANË-
Projektligji për krijimin e Byrove të Kreditit po prezantohet si një
hap dr...

98.33 pikë në letër, por sa të sigurta janë
realisht sistemet e shtetit shqiptar?

Insights

12 Gusht 2026, 12:59

Çfarë interesi i cënohet Begajt që godet
lojtarët e Kombëtares?

Insights

10 Gusht 2026, 16:53

Berisha dhe Rugova: Kur Udhëheqësi Bëhet Më i Madh se Partia

Insights

10 Gush 2026, 11:51

Vapa në vendin e punës: Kur temperaturat e larta bëhen çështje mirëqenieje, mes stresit dhe produktivitetit

Insights

8 Gush 2026, 15:54

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.